

2156

229/3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 5884/1 prot.

Ersekë më 03.02.2023

Lënda: Kthim përgjigje

Qendrës Res Publica
Blv "Gjergj Fishta", Nd 24, H.3, Ap.7, Tiranë

I/E nderuar,

Në përgjigje të shkresës suaj numër 229 Prot. datë 05.12.2022 protokolluar pranë Bashkisë Kolonjë me numër 5884 Prot. datë 09.12.2022 ju bëjmë me dije se në vitin 2020 me urdhër të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit (MMT) u ngritën grupe pune për rishikimin e zonave të mbrojtura në rang qarku pasi kishte mbivendosje të hartave dhe sipërfaqeve përkatëse.

Të gjitha të dhënat e mbledhura u pasqyruan nga grupi i ekspertëve pranë K.K.R.T-së e cila me ekspertët e saj përcaktoi kufijtë përfundimtar duke u bazuar te Konventa Europiane e Mjedisit dhe për çdo sipërfaqe e cila lidhet me vlera mjedisore të larta janë futur në zonat e mbrojtura të Shqipërisë. Dhe pikërisht kjo sipërfaqe është futur e tillë pasi brenda saj ndodhen Burimet e Avullit të Postëpanit dhe po studihet prania e Riqebullit të Ballkanit.

Konceptoi:
Edrion Ajazi

Kryetari
Erion Isai

